



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë më, 19.7.2018

Dokument parlamentar

RAPORT PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, PËR PROJEKTIN E KONEKTIVITETIT TË RRUGËVE RAJONALE DHE LOKALE”

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, shqyrtoi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin e konektivitetit të rrugëve rajonale dhe lokale”, në mbledhjen e datës 19 korrik 2018.

Të pranishëm në mbledhjen e Komisionit për të prezantuar projektligjin dhe për t’u dhënë shpjegime pyetjeve të deputetëve, ishin përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe të Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

Projektligji synon ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin e konektivitetit të rrugëve rajonale dhe lokale, nëpërmjet akordimit të një huaje në shumën 50 milionë USD

Projekti i konektivitetit të rrugëve rajonale dhe lokale është në kuadër të programit të 100 fshatrave dhe objektivat e tij lidhen me përmirësimin e aksesit në qendrat e përzgjedhura bujqësore dhe turistike, si dhe me forcimin i kapaciteteve të bashkive për të menaxhuar asetet e tyre rrugore.

"Programi i 100 Fshatrave" është programi i qeverisë shqiptare i miratuar me qëllim kthimin e 100 fshatrave në territorin e saj në modele të zhvillimit rural nëpërmjet një qasjeje të ndërhyrjes ndërqeveritare ndërinstitucionale për mundësimin e ndërhyrjeve zhvillimore në zonat rurale.

Projekti përbëhet nga 3 pjesë që janë:

- Përmirësimi i aksesueshmërisë përmes rehabilitimit për t’i rezistuar ndikimeve klimatike dhe nismave për sigurinë rrugore;
- Ndërtimi i kapaciteteve për bashkitë përmes ndërtimit të kapaciteteve bashkiake për të menaxhuar dhe mirëmbajtur rrjetet rrugore dhe ndërtimit të ekonomive të reja;
- Mbështetja për menaxhimin e zbatimit përmes mbështetjes së Njesisë së Zbatimit të Projektit.

BERZH-i do t'i akordojë qeverisë shqiptare një shumë prej 50,000,000 dollarë amerikanë, për të ndihmuar për financimin e Projektit të konektivitetit të rrugëve rajonale dhe lokale

Huaja e akorduar nga BERZHI ka termat e mëposhtme:

- Shuma e huasë është 50 milionë dollarë
- Tarifa e parapagimit është një e katërta e një për qind (0.25%) e shumës së kredisë.
- Tarifa e angazhimit është një e katërta e një për qind (0.25%) në vit të Bilancit të Huasë së Patërhequr.
- Norma e interesit është Norma e Referencës, plus Shpërndarja Fikse.
- Datat e pagimit janë data 1 mars dhe 1 shtator e çdo viti.
- Afati i fundit për tërheqjen e fondeve në kuadër të kësaj marrëveshjeje huaje është data 31 dhjetor 2022.
- Maturimi është 29.5 vjet duke përfshirë periudhën prej 6 vitesh pa pagesë principali.

Ky financim u pa i domosdoshëm për shkak të problematikave infrastrukturore dhe nevojës për përmirësim në rrugët lidhëse rajonale, potencialit turistik që kanë zonat e projektit, si dhe vlerësimit të prioriteteve të qeverisë shqiptare me fokus zhvillimin e infrastrukturës.

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni me shumicë votash u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare. Deputetët e opozitës nuk morën pjesë në mbledhje.

Andrea MARTO

Eduard SHALSI

Relator

Kryetar